

GRIP 025

ASTAR (FONDO) RIEMPITIVO UNIFORMUES AKRILIK PËR SIPËRFAQE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME

SERI 478

PËRSHKRIMI

GRIP 025 është produkt (astar) që pigmentoset, me bazë uji në dispersion akrilik, I aplikueshëm me pinel ose rrul.

Formulimi I tij I veçantë I jep atij një fuqi të lartë riempitive (mbushëse) dhe maskuese të parregullsive të sipërfaqes, duke rivendosur "efektin e suvasë (l'effetto intonaco)".

Është I përshtatshëm edhe për ndërhyrjet në pllakat e kartonxhesit, në rastet që kërkohet që finitura të ketë efektin e suvasë (effeto intonaco).

GRIP 025 rezulton bazë e përshtatshme për veshje (rivestimenti) të shpatulluara (patinuara); për më tepër është I përshtatshëm për uniformimin e mureve që shfaqin çarje/krisje të vogla.

ISTRUKSIONE PËR PËRDORIM

I aplikueshëm në:

- Suva të reja dhe të vjetra.
- Sipërfaqe gipsi dhe kartonxhesi.
- Bojra të vjetra dhe veshje me natyrë organike ose minerale, të thata, kompakte, absorbuese dhe kohezive.
- Sipërfaqe me natyrë minerale me kusht që të jenë absorbuese.
- Nuk mund të përdoret si bazë për ciklet minerale (gëlqere dhe silikate).
- Sipërfaqet përgatiten sipas shpjegimit në paragrafin "**Përgatitja e sipërfaqes**".
- Mos aplikoni në sipërfaqe të freskëta (të sapo suvatuara) dhe me tendencë alkaline, prisni një kohë të përshtatshme maturimi (tharje) përgjithësisht 4 javë.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Natyra e lidhësit: kopolimer akrilik
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1: $1.55 \pm 0,05$ kg/l
- Viskoziteti I paketimit UNI 8902: 36000 ± 3200 cps në 25 °C (viskozimetër rrotullues Brookfield)
- Granulometria mesatare: 0,25 mm
- Tharja (në 25 °C dhe 65% U.R.): prekja pas 1 ore; shtresa tjetër pas 4 orësh.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

- Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe e maturuar. Nëse është nevoja siguroni konsolidim me produkte specifike.
- Në prani të mykut trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).

-Hiqni, me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, pluhurat prezente dhe pjesët e ngritura (jo mire të aderuara) të bojës së vjetër. Eliminoni tërësisht pjesët e ciflosura të bojës në gëlqere ose në tempera.

-Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim.

Sipërfaqet në suva:

-Në sipërfaqe të brendshme niveloni parregullsitë e sipërfaqes dhe trajtoni vrimat, gropëzat, çarjet me TAMSTUCCO 9400006/9410110. Zmeriloni çarjet e stukuara me letër zmerile.

-Mbyllni çarjet me STUCCOFACILE 9560019 ose me ngjitës (stuko) të përshtatshëm.

-Plasaritjet dhe uljet (diferencat ndërmjet strukturave) mund të trajtohen me RASAMIX 9440160 ose me BETOMARC 9450150 ose me RASOMARC 9500150 në bazë të llojit të sipërfaqes.

-Në prani të sipërfaqeve me shumë pluhur, ose në rastin e jo-homogjenitetit të theksuar të sipërfaqes, aplikoni një shtresë astar të mikronizuar me bazë uji, solvent free ATOMO 8840001.

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe aplikoni një shtresë GRIP sipas metodave të përshkruara në udhëzimet për aplikim.

Sipërfaqet në gips dhe kartonxhes:

-Në sipërfaqet e brendshme niveloni parregullsitë e sipërfaqes dhe trajtoni vrimat, gropëzat, çarjet me TAMSTUCCO 9400006/9410110; Zmeriloni çarjet e stukuara me letër zmerile.

-Mbyllni çarjet me ngjitës (stuko) të përshtatshëm.

-Kryeni zbutje në sipërfaqe me RASAMIX 9440160 ose me BETOMARC 9450150 ose me RASOMARC 9500150 në bazë të llojit të sipërfaqes.

-Aplikoni një shtresë astar të mikronizuar solvent free ATOMO 8840001.

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe aplikoni një shtresë GRIP 025 sipas metodave të përshkruara në udhëzimet për aplikim.

* (Hollimi I astarit dhe sasia për tu aplikuar janë në funksion të absorbimit të sipërfaqes dhe përcaktohen me prova paraprake në sipërfaqe specifike. Konsultohuni me skedën teknike përkatëse).

GRIP 025

ASTAR (FONDO) RIEMPITIVO UNIFORMUES AKRILIK PËR SIPËRFAQE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME
SERI 478

UDHËZIME PËR APLIKIM

- Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:
Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C
- Lagështira relative e ambientit: <75%
- Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C
- Lagështira e sipërfaqes: <10%
- Shmangni aplikimet në sipërfaqe që janë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të diellit ose me kondensim.
- Pas aplikimit, sipërfaqet duhet të jenë të mbrojtura nga shiu dhe lagështira deri në tharjen e plotë të produktit që normalisht (në 20 °C) arrihet pas 48 orësh.
- Mjetet: pinel, rrul.
- Hollimi: 30-40% me ujë;
- Përziejeni produktin para aplikimit.
- Nr i shtresave: të paktën 1 shtresë.
- Pastrimi i mjeteve bëhet menjëherë pas përdorimit, me ujë
- Shkalla e mbulimit: 5-7 m²/l për shtresë në sipërfaqe mesatarisht poroze. Është mirë që të përcaktohet rrezja efektive me një provë paraprake në sipërfaqe specifike.

NGJYROSJA

Produkti është i disponueshëm i bardhë. GRIP 025 mund të pigmentoset/ngjyroset me pastat e Sistemit Tintometrik Marcromie dhe me kolorantët COLORADO seri 548, deri në një maksimum prej 5%.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30 °C
Temperatura minimale e ruajtjes: +5 °C
Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)
Kat. G: primer/astar (bazë uji): 30 g/l (2010)
GRIP 025 Përmban max: 30 g/l VOC
Produkti nuk kërkon etiketim sipas D.L. 65 te 14/03/03 dhe modifikimeve/ azhornimeve.
Përdoreni produktin sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë; pas përdorimit mos I hidhni mbetjet në ambient, I lini të thahen dhe I trajtoni ato si mbetje të veçanta. Mbajeni larg përdorimit nga fëmijët.
Përdoreni në vende të mirë ventiluara. Në rast të

kontaktit me syte, lajini menjëherë me ujë të bollshëm.

Në rast të gëlltitjes, konsultohuni menjëherë me mjekun dhe i tregoni enën ose etiketën.
Mos I hidhni mbetjet/ambalazhet në kanalizime, terren.

Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

Astar akrilik me efekt suvaje ("effetto intonaco"). Aplikimi, në sipërfaqe të parapërgatitura për GRIP 025 kod.4780019, me bazë rezinë akrilike në dispersion ujor, në sasinë e përcaktuar nga absorbimi I sipërfaqes.
Furnizimi dhe instalimi i materialit € për m².

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.